

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Studime Master – Drejtimi Civil dhe Pronësor

Kandidatja : Miranda Murturi

Mentori : Prof.Ass.Dr.Qerkin Berisha

Titulli i temës: Kontratat për tjetërsimin e paluajtshmërive sipas të Drejtës Pozitive në Kosovë (përmbajtja dhe kushtet për vlefshmërinë e tyre)

ABSTRAKT

Në këtë punim masteri do të paraqesim se cilat janë kontratat me anë të cilave bëhet tjetërsimi i paluajtshmërive sipas të drejtës pozitive në Kosovë. Përveq prezantimit të kontratave, në këtë punim do të flitet edhe se cka duhet të përmbajnë kontratat si të tilla dhe cilat kushte duhet të plotësohen për vlefshmërinë e tyre, pasi që pavlefshmëria e kontratave në fjalë ka pasoja edhe në fitimin e pronësisë, e drejtë kjo shumë e rëndësishme dhe e ranguar në të drejtat e karakterit absolut dhe e garantuar me akte ndërkombëtare dhe akte nacionale.

Gjatë punimit në fjalë janë analizuar dhe krahasuar legjislacioni vendor me atë ndërkombëtar, në mënyrë që të vihen në pah rregullimet sipas të drejtave të vendeve të ndryshme për çështjen e njejtë. Kemi bërë krahasime kryesisht sa i përket fitimit të pronësisë e poashtu edhe definimin apo trajtimin e kontratës së shitjes, kontratës së këmbimit, kontratës për dhuratën, kontratës për mbajtjen e përjetshme dhe kontratës për bashkëinvestimin.

Fjalët kyçe: kontratë, shitje, dhuratë, këmbim, mbajtje e përjetshme, bashkëinvestim, fitimi i pronësisë.